



Bashkia Tiranë



Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe
Edukimit të Fëmijëve

PROGRAMI I EDUKIMIT PËR FËMIJËT 18-36 MUAJ MUAJI NËNTOR



PËR STAFIN EDUKATOR TË ÇERDHEVE PUBLIKE TË TIRANËS

www.femijetetiranes.al

“Kuriozitete për Muajin Nëntor”



Çfarë mund të dimë për Nëntorin?

- * Muaji Nëntor është muaji i tretë i vjeshtës.
- * Në Nëntor, ditët bëhen më të shkurtra dhe më të ftohta se ditët në Tetor.
- * Frutat si **mandarinat, portokallet, shegët, hurmat**, ne nisim t'i shijojmë në Nëntor.
- * Nëntori është muaji i të drejtave të fëmijëve.
- * Nëntori është muaji i festave kombëtare të vendit tonë: Dita e Pavarësisë dhe Dita e Çlirimit.

Muaji Nëntor - Tema: Njohja e Vetes & Të drejtat e Fëmijëve

Grupi miks: 18-36 muaj

- * **Java I:** Njohja e vetes
- * **Java II:** Identifikimi sipas gjinisë, veshjet për fëmijë, veshjet për kukulla.
- * **Java III:** Të drejtat e fëmijëve
- * **Java IV:** Njohja me festat & Festimi i tyre



Tema mujore: Njohja e Vetes & Të drejtat e Fëmijëve

Temat Javore	Qëllimi	Koha e realizimit
Njohja e vetes	Njohja me elementët e vetes.	Java I
Njohja me gjinitë	Njohja me gjinitë dhe veshjet për fëmijë e kukulla.	Java II
Të drejtat e fëmijëve	Njohja me të drejtat e fëmijëve. Konventa e fëmijëve.	Java III
Njohja me festat & Festimi i tyre	Njohja me disa nga festat kryesore/Festat e Nëntorit.	Java IV



Shënim:


- * Stafi edukator duhet ta realizojë sa më qartë shpjegimin dhe realizimin e aktiviteteve me qëllim përvetësimin sa më thjeshtë të njohurive nga fëmijët.
- * Stafi edukator duhet të informojë prindërit mbi tematikën mujore/javore për të siguruar bashkëpunimin e tyre dhe diskutimin me fëmijët në shtëpi.

Tema mujore: Njohja e Vetes & Të drejtat e Fëmijëve

Tema e javës I: Njohja e Vetes



Java I	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
<p>E Hënë</p>	<p>Fytyra Imë</p> 	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë - Edukatorja iu shpjegon/tregon/pyet fëmijët mbi shqisat/tiparet e fytyrës. Edukatorja pyet fëmijët: Ku është syri/hunda/goja/veshi etj? Ku e ke gojën ...Lola...? Çfarë ngjyre i keni sytë?</p> <p>Vjersha: “Këtu jam unë”</p> <p>Loja: “Me pasqyrë”</p> <p>Vizatimi/ Ngjyrosja: “Shprehi të fytyrës”- përmes vizatimit ose mimikës edukatorja të shpjegojë rreth gjendjeve emocionale të fytyrës p.sh. kur jemi të gëzuar (qeshim)/të inatosur (rrudhim vetullat)/kur çuditemi (hapim sytë dhe gojën) dhe t’i angazhojë fëmijët t’i shprehin këto emocione.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike</p>
<p>E Martë</p>	<p>Trupi Im</p> 	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë - Edukatorja iu shpjegon/tregon/pyet fëmijët mbi pjesët e trupit. Ku është dora/ këmba/ barku etj? Ku e ke dorën ...Lola...? Sa duar/ gishta/ këmbë kemi? (vijon dhe me numërimin e tyre).</p> <p>Vjersha: “Këtu jam unë”</p> <p>Kënga: “Këngë lëvizore”(1 ose 2)</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete Didaktike</p>

		Vizatimi/ Ngjyrosja: “Pjesët e trupit” - ngjyrosja e formave/ modeleve nga fëmijët të pregatitura më parë nga edukatorët.	
E Mërkurë	Ky/kjo në pasqyrë jam Unë! 	Bisedë: Edukatore-fëmijë - Edukatorja iu shpjegon/tregon fëmijëve mbi pasqyrën për të parë veten. Në pasqyrë shohim/dallojmë kokën/fytyrën/trupin. “Pasqyrë...moj pasqyrë...ku është këmba/dora ime?” Loja: “Me pasqyrë” Loja: “Pikturimi me gishta” (bërja e gjurmës së gishtave/dorës/këmbës). Vjersha: “Këtu jam unë” Kënga: “Këngë lëvizore” (1 ose 2).	Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Pasqyrë
E Enjte	Emri IM!	Bisedë: Edukatore-fëmijë - Edukatorja fillimisht shpjegon që të gjithë njerëzit kanë një emër. Emri vendoset kur ne vijmë në jetë. Loja: “Si e kam emrin”- Edukatorja pyet çdo fëmijë për emrin/nxit dialogun për mësimin e emrave të njëri-tjetrit. Mësimi i emrit të shokut/shoqes që luan më shumë. Kënga: “Këngë lëvizore” Loja: “Sylla-mbylla” (thirret emri) Përrallë e lirë - ilustrim i figurave (sipas librave që disponojnë në grup).	Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Libra, revista
E Premte	Përsëritja e aktiviteteve të javës	Bisedë: Përsëritja mbi elementët e trajtuara gjatë javës. Vjersha: “Këtu jam unë” Kënga: “Këngë lëvizore” Loja: “Si e kam emrin & Me pasqyrë” Krijimi: “Revista që tregon për mua” – grupimi i elementëve të fytyrës dhe trupit (ose foto personale të sjella nga shtëpia) që fëmija ka vizatuar gjatë javës. Vendosja e emrit mbi to.	Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Foto të familjeve të fëmijëve

Tema mujore: Njohja e Vetes & Të drejtat e Fëmijëve

Tema e javës II: Identifikimi sipas gjinisë, veshjet për fëmijët dhe kukullat




Java II	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	<p>Unë jam Vajzë Unë jam Djalë</p> 	<p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu shpjegon/tregon fëmijëve se kur vijnë në jetë jemi vajzë ose djalë. Edukatorja pyet fëmijët: Po ti çfarë je...vajzë apo djalë? Vjersha: “Çdonjëri prej nesh është i bukur” Lojë energjike: “Me top” Lojë: “Me kuba dhe blloqe ndërtimi”.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave</p>
E Martë	<p>Çfarë veshin fëmijët?</p> 	<p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve veshjet karakteristike si: pantallonat/bluzat /fundi/xhaketa fustani/kapele/kordele koke/karfica etj. Edukatorja pyet: Çfarë ke veshur ti...Arba? Drini çfarë ka veshur Sidita? Po Joni? Vjersha: “Jam një vajzë simpatike/Çdonjëri prej nesh është i bukur” (me zgjedhje) Punim dore: “Veshjet në muajin Nëntor”(fletë punëdore ose copa). Përrallë: “Hirushja/ Borëbardha/Frozen” (me zgjedhje).</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike Libra, revista</p>




<p>E Mërkurë</p>	<p>Çfarë veshin kukullat?</p> 	<p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu demonstroi fëmijëve veshjet e kukullave që ndodhen në grup: këmisha/pantallonat/fustane, kapelet, etj. Edukatorja pyet: Çfarë kanë veshur kukullat? Vjersha: “Çdonjëri prej nesh është i bukur”. Loja: “Kukulla që vishet” (vishen kukullat). Vizatim/Ngjyrosja: “Veshje për kukulla”- ngjyrosja e formave/modeleve nga fëmijët, të përgatitura më parë nga edukatorët. Përrallë: “Pinoku”</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike Libra, revista</p>
<p>E Enjte</p>	<p>Dëshirat e fëmijëve</p>	<p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja pyet fëmijët: Çfarë dëshiron më shumë ti Arba? Po ti Drini? Çfarë lodre/lojë/libri pëlqen ti Arba? Po ti Joni? Vjersha: “Jam një vajzë simpatike/Gimi i vogël” Loja: “ Mua më pëlqen. Po ty/asaj/atij” Loja energjike: “Me litar” (ndarja në dy grupe-vajza/djem).</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave</p>
<p>E Premte</p>	<p>Përsëritja e aktiviteteve të javës</p>	<p>Bisedë: Përsëritja mbi elementët e trajtuara gjatë javës. Vjersha: “Jam një vajzë simpatike/Çdonjëri prej nesh është i bukur/Gimi i vogël”. Loja: “ Mua më pëlqen. Po ty/ asaj/atij?” Loja energjike: “Me litar/ Hedhja e topit në kosh/Me karrige”.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave</p>

Tema mujore: Njohja e Vetes & Të drejtat e Fëmijëve

Tema e javës III: Të drejtat e fëmijëve





Java III	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	<p>Njohja me disa nga të drejtat themelore të fëmijëve</p> 	<p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu shpjegon/tregon/flet fëmijëve për disa nga të drejtat themelore të tyre: Ju keni të drejtë: të keni një emër/të keni një familje/të keni përkujdesje nga të rriturit/të thoni mendimin dhe dëshirat tuaja/të luani/të mos lëndoheni, etj, (edukatorja mund të shprehë dhe të tjera nëse e sheh të nevojshme).</p> <p>Vjersha: “Të drejtat e fëmijëve”</p> <p>Punëdore: “Pema e të drejtave”- përgatitja në forma të ndryshme sipas dëshirës.</p> <p>Lojra të lira: “Roza-rozina/Me blloqe/ Me kuba” (të ndarë në grupe).</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike</p>
E Martë	<p>E drejta për të patur emër</p>	<p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu shpjegon/tregon fëmijëve se kur lindim prindërit na vënë një emër: Të gjithë fëmijët duhet të thirren në emrin që kanë.</p> <p>Loja: “Si e kam emrin”- Edukatorja thërret çdo fëmijë në emër/nxit dialogun për mësimin e emrave të njëri-tjetrit.</p> <p>Vjersha: “Të drejtat e fëmijëve”</p> <p>Punëdore: “Pema e të drejtave”- përgatitja në forma të ndryshme sipas dëshirës.</p> <p>Lojë: “Loja e telefonit”- improvizimi i komunikimit të fëmijëve me telefon duke thirrur emrat e njëri-tjetrit p.sh: Alo Miri! Alo Ema!</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike</p>

<p>E Mërkurë</p>	<p>E drejta për të patur familje</p> 	<p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu shpjegon/ tregon fëmijëve rreth familjes. Ne kemi prindër/motër/vëlla/gjysh/gjyshe. Jo të gjitha familjet janë të njëjta për nga përbërja, por të gjitha janë të ngrohta, na falin dashuri, etj, (edukatorja mund të shprehë të tjera ide nëse e sheh të nevojshme). Vjersha: “Familja” Vizatim/Ngjyrosja: “Familja ime”-vizatim i lirë dhe ngjyrosja e formave/modeleve nga fëmijët të përgatitura më parë nga edukatorët. Ekspozitë: “Me foto familjare” - Edukatorët të bashkëpunojnë me prindërit për të sjellë foto. Përralla: “Mama dhia dhe kecat”.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Libra, revista</p>
<p>E Enjte</p>	<p>E drejta për të luajtur</p> 	<p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu shpjegon/ tregon fëmijëve që secili/secila ka dëshirë, por dhe të drejtë të luajë. Fëmijët duhet të kenë lodra dhe hapësira për të luajtur si brenda dhe jashtë (shtëpi, çerdhe, parqe etj). Edukatorja pyet: Çfarë loje të pëlqen më shumë? Çfarë lodre pëlqeni më shumë? Vjersha: “Të drejtat e fëmijëve” Punëdore: “Pema e të drejtave”- përgatitja në forma të ndryshme sipas dëshirës. Loja: “Me kukulla/Me top/Me makina” (sipas dëshirës).</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike</p>
<p>E Premte</p>	<p>Festimi i Konventës së të Drejtave</p> 	<p>Ekspozimi: “Pema e të drejtave”- në kënde të caktuara. Bisedë: edukatore-fëmijë: Përsëritja e të drejtave të mësuara gjatë javës (referuar pemës së të drejtave). Aktivitet festiv në grup: “Këngë, recitime, valle etj”.</p>	<p>Mjete në grup</p>

Tema mujore: Njohja e Vetes & Të drejtat e Fëmijëve

Tema e javës IV: Njohja me festat & Festimi i tyre



Java IV	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	Njohja me festat 	<p>Bisedë edukatore-fëmijë - Edukatorja iu shpjegon/tregon fëmijëve për disa nga festat kryesore që festojmë si: ditëlindja, 1 Qershori, Viti i Ri etj. Edukatorja shpjegon dhe pyet për ditëlindjen më të afërt të festuar prej fëmijëve ose festa të tjera.</p> <p>Vjersha: “Gëzuar ditëlindjen Elonë”</p> <p>Këngë: “Bufi bëri dasëm” (të shpjegohet kuptimi i këngës).</p> <p>Loja: “Kartolina e festave”</p> <p>Përralla: “Hirushja”.</p>	Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike Libra, Revista
E Martë	Festimi i ditëlindjes 	<p>Bisedë edukatore-fëmijë - Edukatorja iu shpjegon/tregon fëmijëve si mund të festohet një ditëlindje. Si vishemi...më bukur...Çfarë dhurate i bëjmë shokut/shoqes? Si e zbukurojmë ambientin?</p> <p>Vjersha: “Gëzuar ditëlindjen Elonë”</p> <p>Këngë: “Kënga e ditëlindjes”(shumë urime për ty...)</p> <p>Punë dore: “Paketimi i dhuratës”</p> <p>Përralla: “Bardhoshja ka ditëlindjen” (referuar teatrit).</p>	Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike Libra, Revista

<p>E Mërkurë</p>	<p>Festat e Nëntorit</p> 	<p>Bisedë edukatore-fëmijë - Edukatorja iu shpjegon/tregon fëmijëve për Festat e Nëntorit (në terma shumë të thjeshta). Edukatorja i njih fëmijët me flamurin/shpjegon ngjyrat kuq e zi. Vizatim/Ngjyrosja: “Flamuri”- ”-ngjyrosja e formave/ modeleve nga fëmijët të pregatitura më parë nga edukatorët (theksohen ngjyrat). Punë dore: “Pregatitja e flamujve për festa” (shoqëruar me numërimin dhe njohja e konceptit: flamur i madh ose i vogël). Lojra energjike: “Me karrige/me shami etj”.</p>	<p>Manuali i Lojrave Mjete Didaktike</p>
<p>E Enjte</p>	<p>Zbukurimi i çerdhes për festa</p> 	<p>Aktivitet në grup: Edukatore-fëmijë bashkarisht zbukurojnë grupet me flamuj të pregatitur një ditë më parë, tollumbacë dhe elementë të tjerë dekorativ që disponojnë (shoqëruar me shpjegim nga ana e edukatores, pyetje të thjeshta, theksohen ngjyrat, numërimi). Vjersha: “Flamuri”. Këngë & Kërcim: “Këngët për flamurin” Loja: “Vizatimi dhe piktura”.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike</p>
<p>E Premte</p>	<p>Festimi i Festave të Nëntorit</p>	<p>Improvizim sfilate: Edukatorët të bashkëpunojnë me prindërit që fëmijët të vishen me veshje kuq e zi ose kostume popullore. Pregatitja e një sfilate të thjeshtë në grup. Ekspozitë: “Elementët festiv” të cilat janë bërë gjatë javës. Demonstrimi i tyre. Përsëritja: Vjershat dhe këngët e javës. Aktivitet festiv në grup: “Këngë, recitime, valle për festat etj”.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave</p>